Në hapësirën ekspozuese të Hamamit të Daut pashës, sonte (20 dhjetor) në orën 20, do të hapet ekspozita retrospektive e artistit Tanas Lulovskit Tane ...



Bëhet fjalë për ekspozitë të njërit prej doajenëve të pikturës bashkëkohore moderne i cili ka lënë gjurmë ta pashlyeshme në zhvillimin dhe afirmimin e artit figurativ bashkëkohor maqedonas. Në kuadër të ekspozitës, që paraqet shënimin e krijimtarisë shumëdekadëshe të Tanas Lulovskit Tane, do të vendosen piktura dhe vizatime nga të gjitha fazat e krijimtarisë së tij, që fillon në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar.

Veprat që do të prezantohen në këtë ekspozitë janë pronë e familjes së autorit, pronë e më shumë institucioneve (IN Galeria Nacionale e Maqedonisë, Muzeu i Artit Bashkëkohor, IN Qendra e Kulturës “Anton Panov” – Strumicë), si dhe pronë e një numri të konsiderueshëm të pronarëve privat.

Ekspozita në fjalë, që është në kuadër të programit vjetor jubilar të Galerisë Nacionale të Maqedonisë për vitin 2018, do të qëndrojë e hapur deri më 20 shkurt të vitit tjetër.